

**AKT – THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AUTO TRON" SHPK**

Sot me datë 24.02.2023, personat:

- **Z. Festim Lutaj**, shtetas shqiptar, lindur më 04.10.1988, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 033606575 dhe nr. personal I81004110F,
- **Z. Olger Bamllari**, shtetas shqiptar, lindur më 15.04.1995, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me nr. BE7377924 dhe nr. personal J50415043P,
- **Shoqëria RB INVEST shpk**, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. M22219043K, me seli ligjore Rruga "Ismail Qemali", Pallati Nr. 7/1, Shkalla 1, Kati 7, Apartamenti B, Tiranë me përfaqësues ligjor Z. Rolandi Bamllari, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1961, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 032326201 dhe nr. personal G10916033V,

me iniciativën dhe vullnetin e tyre të lirë, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Civil Shqiptar, dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, vendosën të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë:

**Neni 1**  
**Emërtimi**

Shoqëria emërtohet "**Auto Tron**" Shpk (në vijim referuar edhe si "Shoqëria").

**Neni 2**  
**Forma ligjore**

Auto Tron Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar (në vijim referuar si "Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"), dhe në përputhje me këtë Statut.

**Neni 3**  
**Selia**

3.1 Në momentin e nënshkrimit të këtij Statuti, selia e Shoqërisë është në Tiranë, në adresën



## **Rruga e Prezës, Pasuria me 177/9, Zona Kadastrale 3049, Tiranë, Shqipëri.**

3.2 Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

3.3 Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mund të ndryshojë selinë në pikën 3.1, të hapë seli të tjera operative, degë apo zyra përfaqesimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

### **Neni 4 Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj sa vijon:

- Shitje-blerje, tregtim, import-eksport i automjeteve të reja e të përodura të të gjitha llojeve, pjesëve dhe aksesorëve të tyre, modifikim i automjeteve dhe prodhim i aksesorëve;
- Konsulencë mbi produktet automobilistike, veprimtari si agjent në transaksionet e financimit të automjeteve si dhe ofrim shërbimesh në lidhje me operimin e automjeteve, pajisjeve, të pjesëve të tyre përbërëse dhe aksesorëve, si dhe kryerje të çdo aktiviteti tjetër që lidhet me automjetet.
- Dhënie me qira dhe hua të mjeteve të transportit; blerje dhe shitje, ndërtimi, qiraja tregtare ose dhënie në uzufukt ose veprime për llogari të vetë me prona të paluajtshme, si edhe ndërtime të të gjitha llojeve, sidomos ambiente shitjeje, riparimesh, magazinimi dhe ambiente me përdorim për zyra, ndërtesa tregtare dhe garazhe parkimi, si edhe dhënie me qira tregtare të pasurive të luajtshme; shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje të automjeteve dhe dhënie e çdo shërbimi tjetër të lidhur me to.
- Këshillim për veprimet, përfshirë organizimin e veprimtarive, menaxhim të biznesit të agjentit tregtar; pjesëmarrje, madje edhe si ortak i pakufizuar, në shoqëri tregtare dhe organizata që kanë të njëjtin objekt ose objekt të ngjashëm me Shoqërinë.
- Gjithashtu, në peëputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqëria mund të kryejë dhe realizojë çdo aktivitet që lidhet direkt ose indirekt, është si rrjedhim ose ka të bëjë me objektin e renditur më lart.
- Për të arritur qëllimin e mësipërm, Shoqëria mund të ndërmarrë transaksione në lidhje me pasuri të luajtshme apo të paluajtshme dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, për dhënie me qira apo hipoteke, që mund të konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm në mënyrë që të arrihet objekti i Shoqërisë.

### **Neni 5 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar.

### **Neni 6**





## Ortakët

- Ortakët themelues të Shoqërisë janë:
- **Z. Festim Lutaj**, shtetas shqiptar, lindur më 04.10.1988, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 033606575 dhe nr. personal I81004110F, **zotërues i 1 (një) kuote**, me vlerë ALL 340 (treqind e dyzet lekë) që përfaqëson **34% (tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të shoqërisë**.
- **Z. Olger Bamllari**, shtetas shqiptar, lindur më 15.04.1995, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BE7377924 dhe nr. personal J50415043P, **zotërues i 1 (një) kuote**, me vlerë ALL 330 (treqind e tridhjetë lekë) që përfaqëson **33% (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë**.
- **Shoqëria RB INVEST shpk**, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. M22219043K, me seli ligjore Rruga "Ismail Qemali", Pallati Nr. 7/1, Shkalla 1, Kati 7, **zotëruese e 1 (një) kuote**, me vlerë ALL 330 (treqind e tridhjetë lekë) që përfaqëson **33% (tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë**, me përfaqësues ligjor Z. Rolandi Bamllari, shtetas shqiptar, lindur më 16.09.1961, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me nr.032326201 dhe nr. personal G10916033V

6.2. Ortakët përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulojnë personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e Ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të Shoqërisë. Ortakët gëzojnë kuotat e tyre në Shoqëri në përpjesëtim me kontributin e tyre në kapital.

## Neni 7 Kapitali - Kuota

7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën ALL 1,000 (një mijë lekë)

7.2 Kapitali është i përbërë nga 3 (një) kuota me vlerë nominale ALL 1,000 (një mijë lekë).

7.3 Kuotat janë të transferueshme në cdo kohë dhe mund të transferohet në përputhje me kushtet e parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me parashikimet në Statutin e Shoqërisë.

## Neni 8 Administrimi i Shoqërisë

- Shoqëria do të administrohet nga Administratorët e parë të Shoqërisë:
- **Z. Olger Bamllari**, shtetas shqiptar, lindur më 15.04.1995, lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me nr. BE7377924 dhe nr. personal J50415043P, **dhe**
- **Z. Festim Lutaj**, shtetas shqiptar, lindur më 04.10.1988, lindur në Fier dhe banues në Tiranë,

mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 033606575 dhe nr. personal I81004110F,  
të cilët do të kenë këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga momenti i regjistrimit të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

- Administratorët mund të drejtojnë dhe përfaqësojnë shoqërinë me të tretët në mënyrë të pavarur, duke mbajtur të informuar dhe duke konsultuar njëri-tjetrin në kohë të arsyeshme për çdo vendim apo përfaqësim të shoqërisë. Bashkë-administrimi i shoqërisë bazohet mbi parimin e transparencës dhe suksesit të përbashkët.
- Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë Administratorin/ët në çdo kohë me shumicë të thjeshtë të votave pjesëmarrëse në votim nëse plotësohet kuorumi i vendosur në këtë statut.

### **Neni 9 Kompetencat e Administratorëve**

9.1 Veprimtaria tregtare e Shoqërisë menaxhohet nga Administratorët, të cilët mund t'i ushtrojnë veç-e-veç ose bashkarisht të gjitha kompetencat drejtuese dhe përfaqësuese të Shoqërisë me të tretët, duke përfshirë por pa u kufizuar në sa më poshtë vijon, *me përjashtim të kompetencave që i takojnë Asamblesë së Përgjithshme, të parashikuara nga neni 81 të Ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare:*

- zbatimin e politikave të biznesit të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
- sigurimin e përpuethshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe standardeve të kontabilitetit të Shoqërisë;
- kryerjen e të gjitha veprimeve në lidhje me administrimin e veprimtarisë së biznesit të Shoqërisë;
- mirëmbajtjen e rregullt të librave kontabël dhe dokumenteve financiare të Shoqërisë;
- përfaqësimin e Shoqërisë me palët e treta;
- kryerjen e të gjitha regjistrimeve dhe publikimeve të detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
- thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme kur e vlerëson të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
- përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit përmbledhës të Shoqërisë, raportin për ecurinë e Shoqërisë dhe ta paraqesë atë për miratim tek Asambleja e Përgjithshme, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;"
- të punesojë ose të ndërpresë marrëdhëniet e punës me punonjësit sipas politikave të biznesit të Shoqërisë;
- kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në ligjin në fuqi si dhe në këtë Statut;

### **Neni 10 Audituesi Ligjor**

Nëse kërkohet me ligj ose miratohet nga Asambleja e Përgjithshme kontrolli i pasqyrave financiare dhe të dhënave kontabël të Shoqërisë, do t'i besohet një ose më shumë Audituesve Ligjorë.



**Neni 11**  
**Viti ushtrimor dhe pasqyrat financiare**

11.1 Viti ushtrimor i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorëve dhe i Audituesit Ligjor, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Ligjin Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare. Miratimi i dokumenteve në lidhje me pasqyrat financiare do të kryhet çdo vit, brenda gjashtë (6) muajve nga mbarimi i vitit financiar.

**Neni 12**  
**Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë**

12.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për prishjen e Shoqërisë. Prishja e Shoqërisë do të shoqërohet me procedurën e likuidimit të saj. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një ose më shumë likuidatorë, dhe përcaktojë tagrat e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12.3 Me marrjen e vendimit për prishjen dhe likuidimin, Shoqëria vazhdon të ekzistojë si person juridik vetëm për nevoja të likuidimit deri në përfundim të këtij procesi.

**Neni 13**  
**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 14**  
**Dispozita të Përgjithshme**

14.1 Ky Akt për Themelimin e Shoqërisë ka si pjesë të saj edhe **Statutin e Shoqërisë** i cili bashkëlidhet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Përsa nuk parashikohet në këtë Akt themelimi, funksioni, rregullimi dhe organizimi i shoqërisë rregullohet sipas statutit të Shoqërisë.

14.2 Në rast të likuidimit përfundimtar të Shoqërisë, sipas legjislacionit në fuqi, pushon së vepruari edhe ky Akt Themelimi.

14.3 Ky Akt Themelimi perpilohet në 4 (katër) kopje origjinale, me vlerë të njejtë ligjore, në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet nga Ortakët e Shoqërisë me vullnet të lirë e të plotë.

14.4 Njëri nga Administratorët e Shoqërisë do të regjistrojnë këtë Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe do të ndjekin të gjitha hapat e nevojshëm për regjistrimin e Shoqërisë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.

\*\*\*\*\*

Ortakët Themelues të Shoqërisë "AUTO TRON" Shpk

Z. Festim Lutaj

*Festim Lutaj*

Tiranë, datë 24.02.2023

Z. Olgër Bamllari

*Olgër Bamllari*

RB INVEST shpk



**VENDIM NR 01/23**  
**I ORTAKUT TË VETËM**  
**TE SHOQËRISË “RB INVEST” SHPK**  
**Datë 20.02.2023**

Sot, më 20.02.2023, u mbledh rregullisht mbledhja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë “RB INVEST” SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Regjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit, me seli ligjore në adresën: Rruga “Ismail Qemali”, Pallati Nr. 7/1, Shkalla 1, Kati 7, Apartamenti B, Tiranë dhe me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): M22219043K (në vijim referuar si “Shoqëria”), për të diskutuar dhe vendosur lidhur me çështjet e rendit të ditës si vijon:

**RENDI I DITES:**

1. Miratimi i themelimit të një shoqërie të re me përgjegjësi të kufizuar “AUTO TRON” SHPK, me seli ligjore në adresën Rruga e Prezës, Pasuria me 177/9, Zona Kadastrale 3049, Tiranë, të zotëruar 33% (tridhjetë e tre përqind) nga “RB INVEST” SHPK
2. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi ortaku i vetëm i shoqërisë **Z. Rolandi Bamllari**, i cili konstatoi se mbledhja është e vlefshme, pasi Ortaku i Vetëm përfaqëson 100% të kuorumit dhe kapitalit të shoqërisë dhe zotëruar i të gjitha kuotave dhe kështu shqyrton çështjet dhe merr vendim si më poshtë:

Pasi analizuan dhe shqyrjuan çështjet e sipërpërmendura të Rendit të Ditës, Ortaku i Vetëm:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pjesëmarrjen e RB INVEST shpk si ortak dhe bashkëthemelues i shoqërisë së re me përgjegjësi të kufizuar “AUTO TRON” SHPK
2. Kontributi i “RB INVEST” SHPK në kapitalin themeltar të shoqërisë së re “AUTO TRON” SHPK, do të jetë në vlerën ALL 330 (treqind e tridhjetë lekë) e cila përfaqëson 33% të kapitalit të shoqërisë. Pjesëmarrja e bashkë-themeluesve të tjerë të “AUTO TRON” SHPK do të jetë: Festim Lutaj 34% dhe Olger Bamllari 33%. respektivisht, dhe Kapitali (fillestar) themeltar i Shoqërisë të jetë ALL 1000 (një mijë lekë)
3. Autorizohet Administratori i Shoqërisë z. Rolandi Bamllari për të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, nënshkrimin e aktit të themelimit dhe statutin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të “AUTO TRON” SHPK, dhe për nënshkrimin e akteve të tjera të nevojshme për themelimin e shoqërisë së re “AUTO TRON” SHPK;

Ky vendim bëhet efektiv menjëherë pas nënshkrimit të tij në datën e këtij Vendimi. Ortaku i Vetëm konfirmon vendimmarrjen me nënshkrimin e tij:

**Z. Rolandi Bamllari**  


